



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 56P .Prot.

Berat, më 01/02/2018

**Lënda :** Dërgim i Planit të Pranimit në Shërbimin Civil

**Drejtuar :** SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT ,TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar ,neni 18 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.108 datë 26.02.2014 “Për planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil”, bashkëlidhur po ju dërgojmë planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil të Bashkisë Berat për vitin 2018 .

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

KRYETARI I BASHKISË  
Petrit SINAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 568/Prot.

Berat, më 01/02/2018

V E N D I M

Nr. 86 datë 01/02/2018

PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2018, NË INSTITUCIONIN E  
BASHKISË BERAT, PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.108 , datë 26.02.2014”Për planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil”,Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Berat nr.855 Prot , datë 30.11.2017 “Miratimi I strukturës së Bashkisë Berat për vitin 2018”, i ndryshuar, informacionit të Njesisë Përgjegjëse nr. 568 Prot, datë 01.02.2018 “Për pozicionet e lira të krijuara për vitin 2018”, Kryetari i Bashkisë

V E N D O S I:

1.Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim , në administratën e Bashkisë Berat, pjesë e shërbimit civil është gjithsej 5(pesë), sipas kategorive të mëposhtëme:

a)Për kategorinë e mesme drejtuese 1(një)

b)Për kategorinë e ulët drejtuese 1(një)

c)Për kategorinë ekzekutive 3(tre)

2.Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçem në kategorinë ekzekutive janë si më poshtë :

Shkenca Juridike

Shkenca Ekonomike

Arsimi i lartë

3.Drejtoritë ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2018 janë

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Marrdhënieve me Publikun dhe Juridike

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Drejtoria e Kulturës , Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.

4.Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore ,Marrdhënieve me Publikun dhe Juridike, në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Petrit SIMAJ

